

ABSTRAKT

POLITIKA NDESHKIMORE NDAJ VEPRËS PENALE KEQPËRDORIMI I POZITËS APO AUTORITETIT ZYRTARE NË TERRITORIN E GJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS GJATË PERIUDHËS 2015-2019

Kandidate: Dafina Maxhuni

Mentori: Prof. Dr. Rexhep Gashi

Në këtë punim hulumtohet dhe trajtohet politika ndëshkimore ndaj keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, në fushën e normimit të inkriminimeve juridiko-pozitive të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, të zbulimit dhe ndjekjes ndaj kryerësve të kësaj vepre penale si dhe të shqiptimit të dënimeve dhe sanksioneve penale ndaj tyre. Kjo qasje e politikës ndëshkimore ofron një shikim më komplet të masave juridiko-penale dhe të veprimeve të tjera që i ndërmarrin organet e judikaturës penale me qëllim të luftimit dhe parandalimit të këtij lloji të kriminalitetit.

Karakteristikën themelore të kësaj vepre penale e përbën pikërisht cenimi i detyrës zyrtare.

Në parandalimin dhe luftimin efikas ndaj kësaj vepre penale rol të rëndësishëm luan dhe politika ndëshkimore. Andaj qëllimi i këtij punimi është njohja dhe studimi i gjithanshëm i shumë çështjeve thelbësore që kanë të bëjnë me politikën ndëshkimore ndaj veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar në Kosovë, me vështrim të posaçëm në praktikën gjyqësore të Gjykatës Themelore të Prishtinës gjatë periudhës së hulumtuar.

Legjislacioni ynë ka ndërtuar një politikë ndëshkimore adekuate e cila është në harmoni me standardet ndërkombëtare por që në praktikë nga ana e gjykatave zbatohet një politikë ndëshkimore tejet e butë.

Fjalët kyqe: keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, person zyrtar, politikë ndëshkimore.